

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtari individual Mustaf Tahiri, me pjesëmarrjen e sek. juridike, Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.G. nga Prishtina, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par. 5 lidhur me par.3 dhe par.1 të KPK-së sipas aktakuzës së ish PPK-së në Ferizaj PP.nr.246/2010 të dt.03.12.2010, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Veton Shabani si dhe të akuzuarit I.G., më dt.26.05.2016 të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: I.G. nga Prishtina, rr.”.....” nr....., data e lindjes.... , nga i ati I. dhe e ëma Sh. e gjinisë L., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, me profesion autolimar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.përsonal

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 10.01.2010, rreth orës 19.10 në rrugën magjistrale Prishtinë-Kaçanik, përkatësisht afër NTP “Metro” në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e tij të tipit “Opel Kadet” me targë të regjistrimit, nga drejtimi i Prishtinës për në Ferizaj e duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 54/1 të LSKRR-së, ka rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës, nga pakujdesia e godet këmbësorin R.T. nga fsh..... komuna Ferizaj, i cili nga goditja bie mbi parafango dhe nga inercioni përplaslet në asfalt në anën e majtë ku nga drejtimi i kundërt automjeti i tipit “Hyundai Santa” me targë të regjistrimit, të cilën e ngiste H.T. nga fsh..... komuna Fushë Kosovë që ishte në lëvizje, e shkel me rrotën e majtë të përparme, me të cilin rast pos dëmeve materiale lëndim të rëndë trupor pëson këmbësori R.T. dhe atë thyerje të krihve të sipërm dhe të poshtëm të kockës publike në anën e majtë, plagë lacero-kontuzive në regjionin e mjekrës dhe të buzës së poshtme të gojës,

Me të këtë kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par.3 dhe 1 të KPK-së

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe neneve 3,6,11,16,31,32,34,35,38,41,42,43.44 dhe 64 të KPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurin e:

GJYKON

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj dhe në të njejtën kohë urdhëron që dënimi me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të merre formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

I dëmtuari R.T. nga fshati komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ti paguaj shpenzimet në shumën prej 50 € si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Ish Prokuroria Publike Komunale në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.246/2010 të dt.03.12.2010 e ka ngarkuar të pandehurin I.G. nga Prishtina për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par.3 dhe 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 26.05.2016 në të cilin Prokurori i Shtetit Veton Shabani, në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri I.G., në shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, se duke premtuar se ë të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

Me që e pandehura ka pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndes siç janë: mendimi dhe konstatimi i ekspertit lidhur me lëndimet e pësuar nga i dëmtuari R.T., dr.E.Xh.I. i dt.15.11.2010, mendimi i ekspertit të komunikacionit ing.A.A. i datës 01.11.2010, deklarata e të dëmtuarit R.T. e dt.19.10.2010, deklarata e vetë të pandehurit e dt.10.01.2010, raporti mjekësor për të dëmtuarin R.T. i Qendrës Emergjente në Ferizaj nr.protokolli i dt.10.01.2010 si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabim faktik.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari individual konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga nen. 297 par. 5 lidhur me par. 3 dhe 1 të KPK të kryer në kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i pandehuri I.G. duke drejtuar automjetin e tij të tipit “Opel Kadet” me targë të regjistrimit, nga drejtimi i Prishtinës për në Ferizaj e duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 54/1 të LSKRR-së, ka rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës, nga pakujdesia e godet këmbësorin R.T. nga fsh..... komuna Ferizaj, i cili nga goditja bie mbi parafango dhe nga inercioni përplasat në asfalt në anën e majtë ku nga drejtimi i kundërt automjeti i tipit “Hyundai Santa” me targë të regjistrimit, të cilën e ngiste H.T. nga fsh..... komuna Fushë Kosovë që ishte në lëvizje, e shkel me rrotën e majtë të përparme, me të cilin rast pos dëmeve materiale lëndim të rëndë trupor pëson këmbësori R.T. dhe atë thyerje të krihve të sipërm dhe të poshtëm të kockës publike në anën e majtë, plagë lacero-kontuzive në regjionin e mjekrës dhe të buzës së poshtme të gojës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 64 të KPK ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjukata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, një pranim nga ana e të pandehurit ka qenë i sigurtë, se i pandehuri ka shprehur pendim për këtë veprë penale, se i pandehuri pas aksidentit është interesuar për gjendjen shëndetësore, po ashtu si rrethanë lehtësuese gjykata mori edhe se në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit është konstatuar se deri të aksidenti ka ardhur edhe me lëshimet e të dëmtuarit- këmbësori R.T. ku këto lëshime eksperti i ka cilësuar si lëshime sekondare, po ashtu faktin se nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale. Ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjukata të i akuzuari i shqiptoj një dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale.

I dëmtuari R.T. nga fshati komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 450 të KPP-së, gjykata të akuzuari e obligoi që të paguaj shpenzimet e procedurës penale për ekspertizën e komunikacionit dhe për ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej 50 € si dhe të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Në bazë të së theksuares më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ P. nr.168/13 dt. 26.05.2016

Sek.juridike
Drita Ujupi

Gjyqtari individual,
Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit Gjykates së Apelit në Prishtinë nepër mes të kësaj gjykate.